

Date \_\_\_\_\_

**KËRKESË PADI**  
**Drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ...**

- PADITËS:** **Emër Mbiemër**, e bija e... dhe..., e datëlindjes..., lindur në... dhe banuese në..., madhore, me zotësi të plotë për të vepruar.
- Emër Mbiemër**, i biri i... dhe..., i datëlindjes..., lindur në... dhe banues në..., madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.
- OBJEKTI:** Zgjidhja e martesës, miratimi i marrëveshjes për pasojat e martesës.
- BAZA LIGJORE:** Neni 125 i Kodit të Familjes.
- 

I nderuar Z. Kryetar,

Ne, paditësit Emër Mbiemër dhe Emër... Mbiemër..., kemi lidhur martesë më .... Martesa është lidhur pas njohjes së përbashkët dhe bashkëjetesës ... vjecare. Nga kjo martesë kanë lindur Fëmija..., i datëlindjes ... dhe Fëmija..., i datëlindjes .... Gjatë kohëvazhdimin të martesës, ne kemi kontribuar në mënyrë të përbashkët në mbajtjen e familjes dhe krijimin e pasurisë bashkëshortore.

Martesa mes nesh e ka humbur qëllimin e saj dhe ne kemi rënë dakord se ka ardhur momenti për ta zgjidhur këtë martesë. Ky vendim është marrë pas diskutimesh të shumta, këshillimesh me familjarët më të afërt e me një psikolog të specializuar në këto çështje. Aktualisht, ne jemi të bindur se zgjidhja e martesës është veprimi i duhur për ne të dy ... dhe për fëmijët tanë.

Bashkarisht kemi rënë dakord edhe për zgjidhjen e pasojave të martesës dhe më poshtë po ju parashtrajmë projekt-marrëveshjen tonë:

- Paditësja ... do të mbajë mbiemrin e martesës? apo do te ndryshoje mbiemrin ne ..., në mënyrë që të ketë të njëjtin mbiemër me fëmijët dhe të mos jetë e detyruar të ndryshojë dokumentacionin e pronësisë dhe atë bankar.
- Fëmija ... dhe Fëmija ... do të qëndrojnë pranë ... paditëses Emër Mbiemër, e cila do të ketë detyrimin për rritjen dhe edukimin e tyre.
- Paditësi ... Emër1 ... Mbiemër1 do të ketë detyrimin të paguajë shumën prej ...lekë në muaj, si kontribut për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

- Paditësi Emër1 Mbiemër1 do të ketë të drejtën e takimit me fëmijët cdo javë, nga e premtja (mbasdite pas shkolle) deri te dielën (në darkë). Paditësi do të ketë gjithashtu të drejtën t'i marrë ata për pushimet verore, nga data ... qershor deri me datë ... korrik te cdo viti.
- Banesa bashkëshortore, apartamenti i ndodhur në..., i cili është aktualisht i regjistruar në pronësi vetëm të paditësit, është blerë me kontributin e të dy bashkëshortëve. Ky apartament do të kalojë në pronësi të paditëses.
- Apartamenti i II ... nese ka ... i ndodhur me adrese ... , në adresën..., i cili është aktualisht i regjistruar në pronësi .... të të dy bashkëshortëve, do të mbetet në bashkëpronësi të të .... dyve dhe do të përdoret nga të .... dy, me marrëveshje mes tyre.

Bashkëlidhur kërkesë-padisë ndodhen këto prova shkresore:

- Certifikata e martesës,
- Kopje të kartave të identitetit;
- Certifikatat e lindjes së fëmijëve dhe kopje të kartave të tyre të identitetit;
- Vërtetime të të ardhurave të paditësave;
- Certifikata e pronësisë mbi banesën bashkëshortore;
- Certifikata e pronësisë mbi apartamentin e II...

Gjatë gjykimit do të paraqesim shpjegime më të hollësishme, si edhe prova shtesë, nëse do të jenë të nevojshme.

Për sa më sipër, ju kërkojmë ta merrni në shqyrtim këtë kërkesë-padi dhe të vendosni sipas objektit të saj.

Me respekt

**Emër Mbiemër      Emër1 Mbiemër1**